

VENDIM
Nr.22, datë 7.6.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergji Sauli	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar	i	“	“
Kristofor Peçi	Anëtar	i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar	i	“	“
Vjollca Meçaj	Anëtare	e	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Alfred Karamuço	Anëtar	i	“	“

me sekretare Brunilda Bara, në datë 10.4.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.34 Akti, që i përket:

KËRKUES: SHOQËRIA “ARGINERT” SHPK TIRANË.

SHOQËRIA “STUDIOPROJEKT” SHPK TIRANË, të përfaqësuar nga avokatet Fatmira Luli e Hanëme Bakia, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: BASHKIA TIRANË, përfaqësuar nga Natasha Kondi e Albert Lenja, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.624, datë 17.5.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.908, datë 26.5.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f, 134/g e 42/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 16, 20/2 e 28 të Kodit të Procedurës Civile.

Kërkuesit parashtrojnë këto shkaqe kryesore në kërkesën e tyre:

- Gjykatat kanë anashkaluar prova me rëndësi vendimtare për procesin, si dhe kanë deformuar dhe kanë treguar njëanshmëri të hapur në pranimin e vlerësimin e provave.
- Gjykatat nuk kanë analizuar asnjë pretendim të kërkuesve, të referuara në prova shkresore dhe për më tepër kanë mohuar ekzistencën e tyre edhe pse ato ndodhen në dosje.
- Gjykatat kanë shkelur barazinë e armëve.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Alfred Karamuço, përfaqësueset e kërkuesve, përfaqësuesen e subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkuesit, Shoqëria “Arginert” sh.p.k. dhe shoqëria “Studioprojekt” sh.p.k., kanë konkuruar në tenderin e hapur të shpallur nga Bashkia Tiranë me objekt “Zgjerim, sistemim-asfaltim, rehabilitimin e ujësjellës-kanalizimeve dhe rregullimin e trotuareve në rrugën “Punëtorët e Rilindjes”, shtrimin e trotuarëve në të dy krahët e Lanës, në segmentin nga Ura e Rrugës së “Elbasanit” deri tek Ura Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”.

Palët kanë lidhur kontratën e sipërmarrjes në datë 23.5.2001, ndërsa në datë

27.12.2001, janë kolauduar punimet pa ndonjë vërejtje, e mbi këtë bazë është mbajtur procesverbali.

Rezulton se gjatë kryerjes së punimeve objekt kontrate, Bashkia e Tiranës ka kërkuar nga firmat kontraktore, kryerjen e disa punimeve në segmentin nga Ura e “Rrugës së Elbasanit” deri tek P.T.4, punë të cilat janë kryer dhe për të cilat mbi bazën e situacionit të paraqitur në kohën e dorëzimit të punimeve janë likujduar 14 % e vlerës së tyre.

Më pas, edhe pse objektet e mësipërme u morën në dorëzim, Bashkia nuk ka pranuar të likujdojë diferencën e palikujduar të vlerës për punimet në “Rrugën e Elbasanit”.

Kërkuesit kanë bërë padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr.4675, datë 11.11.2003, ka detyruar Bashkinë Tiranë me pagimin e vlerës së punimeve, si dhe të kamatvonesave.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.624, datë 17.5.2004, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e rrëzimin e padisë, vendim të cilin e ka lënë në fuqi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.908, datë 26.5.2005.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se vendimet e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë janë rezultat i zhvillimit të një procesi të parregullt gjyqësor e si të tilla duhet të shfuqizohen si të papajtueshme me Kushtetutën.

Në shqyrtimin e çështjes Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka respektuar parimin e barazisë së armëve në proces e për pasojë ka mbajtur një qëndrim tërësisht të njëanshëm. Duke iu referuar argumenteve të parashtruara në vendim, ballafaquar me provat e paraqitura nga kërkuesit qysh në gjykimin në shkallën e parë, del fare qartë konstatimi i mësipërm i Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata e Apelit Tiranë parashtron shprehimisht se Bashkia e Tiranës nuk ka dhënë pëlqim për punimet në “Rrugën e Elbasanit” dhe këtë e bazon tërësisht në dëshminë e dy punonjësve kryesorë në Bashki, drejtorit të Projekteve të Infrastrukturës dhe drejtorit të Punëve Publike. Gjykata shprehet gjithashtu se kërkuesit nuk paraqitën asnjë provë nga ku të vërtetohej pëlqimi me shkrim i Bashkisë për këto punime. Gjykata e Apelit nuk ka marrë në shqyrtim një numër të konsiderueshëm provash shkresore të paraqitura nga kërkuesit e ndër të tjera dhe shkresën nr.452, datë 23.1.2002 në të cilën vetë Bashkia ka dhënë opinion për cilësi të lartë të punimeve.

Veç thënieve të dëshmitarëve të mësipërm, gjykata e apelit vendimin e saj e argumenton edhe me konsiderata të përgjithshme pa i ballafaquar me provat e paraqitura nga kërkuesit. Kështu, në dosje ka prova shkresore nga del se vetë Këshilli i Ministrave miratoi fond shtesë për punimet dhe se ai u kalua me shkresën nr.669/1, datë 4.2.2002 të Ministrisë së Financave. Duke e injoruar këtë fakt, Gjykata shprehet se “porositësi është ent publik dhe në procesin e zbatimit të kontratës nuk mund të kryejë punime për të cilat nuk është i autorizuar t’i kryejë”.

Në vendimin e saj, Gjykata e Apelit Tiranë, duke iu referuar thënieve të dy dëshmitarëve, në mënyrë abuzive pranon se kërkuesit janë paralajmëruar të mos bënin punimet në Rrugën e Elbasanit”, dhe për këtë përmend shkresën nr.7667/1, datë 11.10.2002. Në fakt, por t’i referohesh kësaj shkrese, e cila është e administruar në dosje, ajo bën fjalë shprehimisht për punimet në objektin “Punëtorët e Rilindjes” e jo për objektin në konflikt dhe se në atë shkresë, drejtori i Punëve Publike tërhiqte vëmendjen e paralajmëronte për mosdorëzimin në kohë të situacioneve për efekte financiare. Duke e përdorur si provë këtë shkresë, gjykata njëkohësisht injoron faktin se në dosje ka të administruara si prova shkresore dokumente të Bashkisë të përpiluara pas datës që mban shkresa e lartpërmendur dhe se në ato kanë firmosur edhe përfaqësues të bashkisë (duke përfshirë edhe drejtorët) lidhur me punimet e kryera, mënjanimin e disa pengesave në terren, kolaudimin e veprës, etj. Po kështu, nga tre supervisorët e punimeve, përfaqësues të Bashkisë, janë nënshkruar rregullisht të gjitha situacionet ditore e ato përmbledhëse. Ata kanë nënshkruar edhe Librezat e Masave duke

përkthyer cilësinë e punimeve dhe vëllimin e tyre.

Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka lënë në fuqi vendimin e mësipërm të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke iu referuar materialeve të ndodhura në dosje dhe pretendimeve të pjesëmarrësve në proces, pranon se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një shtesë të kontratës së sipërmarrjes dhe se kërkuesit nuk mundet të vërtetojnë pretendimet e ngritura. Edhe pse fare i shkurtër, vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, dëshmon për trajtim haptazi të njëanshëm të provave të paraqitura.

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, si dhe e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mëse një herë kanë pranuar si elemente të qenësishme të procesit të rregullt gjyqësor respektimin e parimit të barazisë së armëve lidhur ngushtë me paanësinë në gjykim. Mbi bazën e këtyre standardeve, çdo palë në proces nuk duhet të gjejë avantazhe të konsiderueshme ndaj kundërshtarit, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë midis palëve. Në vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë e atë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, standardet e përmendura janë cenuar ndjeshëm e për këtë shkak ato duhet të shfuqizohen si jo në përputhje me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr.624, datë 17.5.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.908, datë 26.5.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë;
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.